



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2017 – Numri: 179

Tiranë – E martë, 10 tetor 2017

PËRMBAJTJA

	Faqe	
Ligj nr. 92/2017 datë 29.9.2017	Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 2, datë 16.8.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për disa ndryshime në ligjin nr. 130/2016 “Për buxhetin e vitit 2017””.....	9087
Ligj nr. 93/2017 datë 29.9.2017	Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe e Irlandës së Veriut, që plotëson Konventën Europiane për Ekstradimin, të vitit 1957.....	9087
Ligj nr. 94/2017 datë 29.9.2017	Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për Bashkëpunim Financiar 2016, për projektin “Programi për rinovimin e konvikteve në kampusin universitar të Tiranës, sipas parimit të eficiencës energjetike, faza II”.....	9089
Ligj nr. 95/2017 datë 29.9.2017	Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Suedisë për programin “Forcimi i policimit në komunitet në Shqipëri” (2017–2020).....	9090
Vendim i Kuvendit nr. 98/2017, datë 5.10.2017	Për ngritjen e nënkomisionit “Për diasporën dhe migracionin”, në përbërje të Komisionit të Përhershëm Parlamentar për Politikën e Jashtme.....	9097
Vendim i Kuvendit nr. 99/2017, datë 5.10.2017	Për ngritjen e nënkomisionit “Për qeverisjen vendore”, në përbërje të Komisionit të Përhershëm Parlamentar për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.....	9097



LIGJ
Nr. 92/2017

**PËR MIRATIMIN E AKTIT
NORMATIV, ME FUQINË E LIGJIT,
NR. 2, DATË 16.8.2017, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR DISA
NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 130/2016
“PËR BUXHETIN E VITIT 2017””**

Në mbështetje të neneve 78, 101 dhe 160 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Miratohet akti normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 2, datë 16.8.2017, i Këshillit të Ministrave, “Për disa ndryshime në ligjin nr. 130/2016 “Për buxhetin e vitit 2017””.

Miraturar në datën 29.9.2017

**Shpallur me dekretin nr. 10626, datë 9.10.2017,
të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Ilir Meta**

LIGJ
Nr. 93/2017

**PËR RATIFIKIMIN E
MARRËVESHJES NDËRMJET
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
MBRETËRISË SË BASHKUAR TË
BRITANISË SË MADHE E IRLANDËS
SË VERIUT, QË PLOTËSON
KONVENTËN EUROPIANE PËR
EKSTRADIMIN,
TË VITIT 1957**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së

Bashkuar të Britanisë së Madhe e Irlandës së Veriut, që plotëson Konventën Europiane për Ekstradimin, të vitit 1957, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 29.9.2017

**Shpallur me dekretin nr. 10627, datë 9.10.2017,
të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Ilir Meta**

MARRËVESHJE

**NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
DHE MBRETËRISË SË BASHKUAR TË
BRITANISË SË MADHE DHE IRLANDËS
SË VERIUT, QË PLOTËSON KONVENTËN
EUROPIANE PËR EKSTRADIMIN, TË
VITIT 1957**

Republika e Shqipërisë dhe Mbretëria e Bashkuar e Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut, në vijim të referuara si “Shtetet Kontraktuese”:

duke pasur në konsideratë të drejtat e njeriut dhe shtetin ligjor;

të ndërgjegjshme për garancitë sipas sistemeve të tyre përkatëse ligjore, të cilat i sigurojnë një personi të akuzuar të drejtën për një gjykim të drejtë, duke përfshirë të drejtën për gjykim nga një gjykatë e paanshme e krijuar me ligj;

duke dëshiruar të plotësojnë dispozitat e Konventës Europiane për Ekstradimin, të 13 dhjetorit 1957 (Konventa Europiane për Ekstradimin) dhe të lehtësojnë funksionimin e saj ndërmjet Shteteve Kontraktuese, në mënyrë të veçantë në lidhje me ekstradimin e shtetasve të tyre përkatës;

si rrjedhojë e deklaratës së bërë nga Shqipëria në lidhje me nenin 6(1) të Konventës Europiane për Ekstradimin dhe të përfshirë në instrumentin e saj të ratifikimit dhe të depozituar më 19 maj 1999, me qëllim që Shqipëria të refuzojë të ekstradojë shtetasit e saj, përveç nëse parashikohet ndryshe në një marrëveshje ndërkombëtare në të cilën Shqipëria është palë (Deklarata shqiptare);

duke synuar, në kuadër të dhe në përputhje me Deklaratën shqiptare, eliminimin e pengesave ligjore ndaj ekstradimit të shtetasve



të shtetit të kërkuar, të kërkuar për ndjekje penale ose për kryerjen e një dënimi në shtetin kërkuar, duke marrë masa për ekstradimin e këtyre shtetasve,

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Ekstradimi i shtetasve

1. Palët Kontraktuese bien dakord se neni 6(1) (a) i Konventës Europiane për Ekstradimin (e drejta për të refuzuar ekstradimin e shtetasve) nuk zbatohet ndërmjet tyre në përmbushjen e detyrimeve të tyre të ndërsjella, sipas Konventës.

2. Si rrjedhojë, ekstradimi nuk refuzohet për arsye se personi i kërkuar është shtetas i shtetit të kërkuar.

Neni 2

Procedurat e ekstradimit

1. Kërkesat për ekstradim shkëmbehen drejtpërdrejt ndërmjet autoriteteve qendrore; në emër të Republikës së Shqipërisë nga Ministria e Drejtësisë, Drejtoria e Përgjithshme për Çështjet Gjyqësore, në emër të Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut nga autoriteti qendror i Mbretërisë së Bashkuar. Njësia Ndërkombëtare kundër Kriminalitetit në Ministrinë e Brendshme.

Neni 3

Zbatime kohore

1. Kjo Marrëveshje zbatohet për vepra penale të kryera para ose pas datës në të cilën ajo hyn në fuqi.

2. Kjo Marrëveshje nuk zbatohet për kërkesat për ekstradim të marra para datës në të cilën ajo hyn në fuqi.

3. Në rast të përfundimit të kësaj Marrëveshjeje, në përputhje me nenin 5, kërkesat për ekstradim të marra para datës në të cilën Marrëveshja pushon së pasuri efekt, do të vazhdojnë të rregullohen nga kjo Marrëveshje, pavarësisht përfundimit të saj.

Neni 4

Zbatimi territorial

Kjo Marrëveshje zbatohet:

a) për Republikën e Shqipërisë;

b) i) për Mbretërinë e Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut;

ii) për ishujt Channel Islands dhe Isle of Man dhe për çdo territor tjetër për marrëdhëniet ndërkombëtare të të cilit Mbretëria e Bashkuar është përgjegjëse dhe për të cilët zbatimi i Konventës Europiane për Ekstradimin është zgjeruar me marrëveshje ndërmjet Palëve Kontraktuese.

Neni 5

Ratifikimi, hyrja në fuqi dhe përfundimi

1. Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në datën në të cilën të dyja Shtetet Kontraktuese kanë njoftuar njëri-tjetrit nëpërmjet kanaleve diplomatike se kërkesat e tyre përkatëse për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje janë përmbushur.

2. Çdo shtet kontraktues mund të përfundojë këtë Marrëveshje në çdo kohë, duke i dhënë njëri-tjetrit njoftim me shkrim. Në këtë rast, Marrëveshja do të pushojë së pasuri efekt gjashtë (6) muaj pas datës së marrjes së këtij njoftimi.

3. Pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, çdo dispozitë e Traktatit të Ekstradimit ndërmjet Shqipërisë dhe Mbretërisë së Bashkuar, të nënshkruar në Tiranë, më 22 korrik 1926, që pavarësisht nga zbatimi i nenit 28(1) të Konventës Europiane për Ekstradimin, mbetet në fuqi (traktati i mëparshëm), do të pushojë së pasuri efekt ndërmjet Palëve Kontraktuese, përveç në rastin e kërkesave të ekstradimit të marra para datës në të cilën Marrëveshja hyn në fuqi.

Në dëshmi të kësaj, të nënshkruar, duke qenë të autorizuar nga qeveritë e tyre përkatëse, kanë nënshkruar këtë Marrëveshje.

Bërë, në Tiranë, më 5 prill 2017, në dy kopje, në gjuhën shqipe dhe angleze, ku të dyja tekstet janë njëllorj autentike.

PËR REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

PËR MBRETËRINË E BASHKUAR TË
BRITANISË SË MADHE DHE IRLANDËS
SË VERIUT



LIGJ
Nr. 94/2017

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES
NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË
REPUBLIKËS FEDERALE TË
GJERMANISË PËR BASHKËPUNIM
FINANCIAR 2016, PËR PROJEKTIN
“PROGRAMI PËR RINOVIMIN E
KONVIKTEVE NË KAMPUSIN
UNIVERSITAR TË TIRANËS, SIPAS
PARIMIT TË EFICIENCËS
ENERGJETIKE, FAZA II”**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunim financiar 2016, për projektin “Programi për rinovimin e konvikteve në kampusin universitar të Tiranës, sipas parimit të eficiencës energjetike, faza II”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 29.9.2017

**Shpallur me dekretin nr. 10628, datë 9.10.2017,
të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Ilir Meta**

MARRËVESHJE

**NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE
TË GJERMANISË PËR BASHKËPUNIM
FINANCIAR 2016, PËR PROJEKTIN
“PROGRAMI PËR RINOVIMIN E
KONVIKTEVE NË KAMPUSIN
UNIVERSITAR TË TIRANËS, SIPAS
PARIMIT TË EFICIENCËS
ENERGJETIKE, FAZA II”**

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë:

në frymën e marrëdhënieve ekzistuese miqësore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë;

duke u nisur nga dëshira për t'i forcuar dhe thelluar këto marrëdhënie miqësore nëpërmjet bashkëpunimit financiar si partnerë;

të ndërgjegjshëm se ruajtja e këtyre marrëdhënieve përbën bazën e kësaj marrëveshjeje;

me qëllim për të kontribuar në zhvillimin social dhe ekonomik në Republikën e Shqipërisë;

duke iu referuar protokollit të bisedimeve ndërqeveritare, të datës 12 korrik 2016, dhe premtimit të Ambasadës së Republikës Federale të Gjermanisë, datë 29 nëntor 2016 (nota verbale nr. 349/2016),

kanë rënë dakord si vijon:

Neni 1

1. Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë i mundëson Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë ose huamarrësve të tjerë, të cilët do të zgjidhen bashkërisht nga të dyja qeveritë, të marrin nga Kreditanstalt für Wiederaufbau (KfW) shumën e financimit në vlerë të përgjithshme deri në 2 032 179,23 euro (me fjalë: dy milionë e tridhjetë e dy mijë e njëqind e shtatëdhjetë e nëntë euro, njëzet e tre cent), për projektin “Programi për rinovimin e konvikteve në kampusin universitar të Tiranës, sipas parimit të eficiencës energjetike, faza II”, nëse nga shqyrtimi përkatës ka rezultuar se projekti vlen për t'u mbështetur.



2. Projekti i përmendur në paragrafin 1 mund të zëvendësohet me projekte të tjera, Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë dhe Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë bien dakord.

3. Në rast se Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë, në një kohë të mëvonshme, i jep mundësi Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë të marrë nga Kreditanstalt für Wiederaufbau hua, shuma të tjera financimi, për masa të nevojshme shoqëruese për zbatimin dhe mbikëqyrjen e projektit, të përmendur në paragrafin 1, gjen zbatim kjo marrëveshje.

Neni 2

1. Përdorimi i shumës së përmendur në nenin 1, paragrafi 1, kushtet me të cilat vihet në dispozicion ajo, si dhe procedura e dhënies së porosisë përcaktohen në kontratat që do të lidhen midis Kreditanstalt für Wiederaufbau dhe të marrësve të shumës së financimit, të cilat u nënshtrohen dispozitave ligjore që janë në fuqi në Republikën Federale të Gjermanisë.

2. Premtimi i shumës së përmendur në nenin 1, paragrafi 1, do të zhvlerësohet, në rast se kontratat përkatëse të financimit nuk do të lidhen brenda vitit aktual. Afati për shumën e përmendur mbaron më 31 dhjetor 2017.

3. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, në rastet kur ai vetë nuk është marrës i shumës së financimit, do të garantojë ndaj Kreditanstalt für Wiederaufbau të gjitha pagesat me euro për shlyerjen e borxheve të marrësve të shumës së financimit, në bazë të kontratave, të cilat do të lidhen sipas paragrafit 1.

Neni 3

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë e përjashton KfW-në nga të gjitha tatimet dhe taksat e tjera publike, që lindin në Republikën e Shqipërisë në kontekstin e lidhjes dhe zbatimit të kontratave, të përmendura në nenin 2, paragrafi 1.

Neni 4

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë e lë në gjykimin e pasagjerëve dhe furnizuesve të zgjedhin lirisht mes ndërmarrjeve transportuese për transportimin e personave

dhe të mallrave në rrugë detare, tokësore dhe ajrore, transport ky që rezulton nga dhënia e shumave të financimit, si dhe nuk merr asnjë masë, e cila përjashton ose vështirëson pjesëmarrjen me të drejta të barabarta të ndërmarrjeve transportuese, me seli në Republikën Federale të Gjermanisë dhe nxjerr, sipas rastit, lejet e nevojshme për pjesëmarrjen e këtyre ndërmarrjeve transportuese.

Neni 5

Kjo marrëveshje hyn në fuqi në ditën kur Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë i njofton Qeverisë së Republikën Federale të Gjermanisë, se janë përmbushur kushtet brendashtetërore për hyrjen në fuqi. Përcaktuese është dita e marrjes së njoftimit.

Bërë në Tiranë, më 2.5.2017, në dy origjinale, secili në gjuhën gjermane dhe shqipe, duke pasur të dyja tekstet fuqi të barabartë.

PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

PËR QEVERINË E REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË

LIGJ

Nr. 95/2017

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES
NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE SUEDISË PËR
PROGRAMIN “FORCIMI I POLICIMIT
NË KOMUNITET NË SHQIPËRI”
(2017–2020)**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Suedisë për programin “Forcimi i policimit në komunitet në Shqipëri” (2017–2020).



Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 29.9.2017

Shpallur me dekretin nr. 10629, datë 9.10.2017, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta

MARRËVESHJE

NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE SUEDISË PËR PROGRAMIN “FORCIMI I POLICIMIT NË KOMUNITET NË SHQIPËRI” (2017–2020)

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Suedia, përfaqësuar nga Agjencia Suedeze e Bashkëpunimit Ndërkombëtar për Zhvillim (SIDA), më poshtë të referuara si palët,

duke marrë parasysh se:

- Pala shqiptare ka kërkuar që pala Suedeze të kontribuojë në zbatimin e strategjisë së Policisë së Shtetit Shqiptar nëpërmjet financimit të projektit: Forcimi i policimit në komunitet në Shqipëri”, (Kontributi ID55020254) gjatë periudhës/vitit fiskal 2017–2020.

- Niveli i financimit i palës shqiptare për Projektin/Programin është reflektuar në buxhetin e shtetit të Këshillit të Ministrave dhe Suedia do të vendosë në dispozicion mbështetje për Projektin/Programin, duke ofruar mbështetje financiare dhe teknike deri në një shumë maksimumi prej 30 000 000 SEK, në bazë të ndarjeve parlamentare të fondeve nga Suedia,

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Objektivat e programit dhe objekti i Marrëveshjes së Posaçme

Objektivi i përgjithshëm i Projektit/Programit është krijimi i besimit të ndërsjellë dhe partneritetit ndërmjet policisë dhe komuniteteve për të krijuar fqinjësi të sigurt, siç përshkruhet në shtojcën 1 “Propozimi i programit: Fuqizimi i policimit në komunitet në Shqipëri”, i datës 31 mars 2015, duke mbuluar një periudhë 4-vjeçare ekzekutimi. Dokumenti i programit, duke

përfshirë kuadrin e rezultateve, si dhe buxhetin në monedhën euro, do të përditësohet nëpërmjet amendimeve me shkrim, sa herë që kërkohen ndryshime të mëdha në kuadër të rezultateve të programit, që janë të nevojshme për zbatimin efektiv, duke marrë në konsideratë rezultatet e çdo vlerësimi dhe rishikimeve të ardhshme, vendimet e marra nga pala shqiptare në bazë të konsultimeve me Suedinë etj., apo planet vjetore të punës për përkrahjen e projekteve, si dhe takimet e Komitetit Drejtues të Programit.

Neni 2

Referenca ndaj marrëveshjeve të tjera

Bashkëpunimi ndërmjet palëve sipas kësaj Marrëveshjeje rregullohet edhe nga:

- Marrëveshja mbi kushtet dhe termat e përgjithshëm për bashkëpunimin për zhvillim ndërmjet palëve, për periudhën 30 qershor 2006 deri në njoftimin për përfundim nga njëra prej palëve;

- Marrëveshja mbi bashkëpunimin për zhvillim ndërmjet palëve, për periudhën 9 shkurt 2017–31 dhjetor 2020; dhe

- Çdo marrëveshje tjetër që mund ta zëvendësojë ose ndryshojë marrëveshjet në fjalë.

Neni 3

Përgjegjësitë e zbatimit dhe përfaqësimi

3.1 Projekti do të realizohet nëpërmjet një konsulenti zbatues/ekipi për menaxhimin e programit (PMI)/që do të tenderohet nëpërmjet një procesi të hapur tenderi të kryer nga Ambasada Suedeze. Komiteti i Përzgjedhjes së Prokurimit do të përbëhet nga një ekip i përbashkët me përfaqësues të Ambasadës Suedeze, një përfaqësues nga Policia e Shtetit Shqiptar dhe një nga Ministria e Punëve të Brendshme. Zbatimi i programit do të kryhet në bashkëpunim të ngushtë ndërmjet konsulentit dhe Policisë së Shtetit Shqiptar dhe, kur është e nevojshme, me Ministrinë e Punëve të Brendshme. Ambasada, Policia e Shtetit Shqiptar dhe Ministria e Punëve të Brendshme do të marrin raportet e projektit dhe përditësimet financiare nëpërmjet takimeve të Komitetit Drejtues të Projektit dhe mjeteve të tjera.



Si një financues, Suedia nuk do të marrë asnjë përgjegjësi dhe/ose detyrim për ndonjë palë të tretë në lidhje me zbatimin e Programit. Suedia do të nënshkruajë një kontratë me fituesit e tenderit, e cila do t'i vihet në dispozicion palës shqiptare, duke përfshirë anekset.

3.2 Këshilli i Ministrave ka autorizuar Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Policinë e Shtetit Shqiptar të jenë përgjegjës përpara Këshillit të Ministrave në lidhje me zbatimin e Programit.

3.3 Çdo komunikim në lidhje me këtë Marrëveshje duhet të bëhet me shkrim, ku të jetë vendosur numri i kontributit të SIDA-s dhe titulli i Projektit/Programit dhe të dërgohet në adresat e mëposhtme:

Për Suedinë

Agjencia Suedeze e Bashkëpunimit Ndërkombëtar për Zhvillim, SIDA/Ambasada Suedeze në Tiranë, rr. "Pjetër Budi", nr. 56.

Në vëmendje të Linda Gjermani

Për Shqipërinë

Ministria e Punëve të Brendshme, Sheshi Skënderbej, nr. 3, Tiranë

Në vëmendje të znj. Zhanina Dapi

Neni 4

Disbursimet

4.1 Suedia do të përpiqet të garantojë parashikueshmërinë e financimit të saj, duke përafuar angazhimet e saj financiare vjetore dhe disbursimet me nevojat e fluksit të mjeteve monetare për ekzekutimin e projektit.

4.2 Palët parashikojnë programin e mëposhtëm të përkohshëm të financimit:

VITI 2017	7000 000	SEK, pas nënshkrimit të kontratës me ekipin e kontraktuar të menaxhimit të programit dhe faturimin tremujor të ambasadës
VITI 2018	8 000 000	SEK, pas miratimit të raportit vjetor të SIDA-s/ambasadës dhe buxhetit të përditësuar dhe analizës së riskut
VITI 2019	8 000 000	SEK, pas miratimit të raportit vjetor të SIDA-s/ambasadës

VITI 2020	7 000 000	SEK, pas miratimit të raportit vjetor të SIDA-s/ambasadës
Kontributi total maksimal	30 000 000	SEK.

4.3. Financimi i siguruar nga Suedia do t'i paguhet si shpenzim i ndodhur, drejtpërdrejt konsulentit zbatues të kontraktuar, pas marrjes dhe miratimit nga Suedia. Disbursimet kushtëzohen me përmbushjen e kërkesave të kësaj Marrëveshjeje të Posaçme, progresit në lidhje me objektivat dhe rezultatet e pritshme të programit, si dhe nevojave aktuale për qarkullim monetar, në përputhje me planet e paraqitura të punës vjetore, duke përfshirë buxhetet. Disbursimet janë, gjithashtu, të kushtëzuara nga një analizë e përditësuar e riskut dhe buxhetit të detajuar, kur partneri kontraktues ka qenë i zgjedhur.

4.4. Pala shqiptare konfirmon se financimi i siguruar nga Suedia do të përdoret ekskluzivisht për të mbuluar shpenzimet e alokuara për Programin, siç është detajuar në dokumentin e Programit dhe i detajuar më tej në planin vjetor të miratuar të punës dhe të buxhetit. Konsulenti i zbatimit/PMT do t'i dërgojë kopje të të gjitha faturave palës shqiptare, në mënyrë që të lehtësojë monitorimin e zbatimit të buxhetit nga ana e palës shqiptare dhe të sigurojë informacion të përditësuar dhe të saktë për shpenzimet e programit, në mënyrë transparente për Shqipërinë.

Neni 5

Menaxhimi financiar

Menaxhimi financiar i programit do të jetë përgjegjësi e drejtpërdrejtë e konsulentit të zbatimit dhe në përputhje me sistemet e tij organizative, financiare dhe menaxhuese. Ekzekutimi i buxhetit do të bazohet në buxhetin e programit dhe do të reflektojë planin e miratuar të punës të rënë dakord mbi baza vjetore dhe që do të specifikohet më tej pas përzgjedhjes së konsulentit zbatues.

Neni 6

Prokurimi

Konsulenti i përzgjedhur i zbatimit/PMT do të kryejë të gjitha prokurimet që do të kërkohen



për programin dhe në përfitim të palës shqiptare. Konsulenti do të kryejë prokurimet në përputhje me planin e dakordësuar të prokurimit, procedurat e veta dhe udhëzimet e prokurimit të SIDA-s (SPG). Udhëzimet e prokurimit të SIDA-s do t'i bashkëlidhen kontratës së Suedisë me konsulentin zbatues që do t'i vihen në dispozicion palës shqiptare pas nënshkrimit. Plani i prokurimit do të përfshijë detaje për secilin prokurim, duke përfshirë procedurat e rena dakord për konsultime me palën shqiptare.

Neni 7

Raportimi financiar

7.1 Ekipi i kontraktuar për menaxhimin e Programit/konsulenti për zbatimin do të përgatisë raporte financiare për Ambasadën e Suedisë, palën shqiptare dhe KDP-në, çdo gjysmë viti, për Programin që nga fillimi i tij. Raportet financiare përfshijnë një analizë të të dhënave financiare me anë të përpilimit të të dhënave, si dhe krahasimeve me vitet e mëparshme. Pasqyrat dhe raportet financiare mbulojnë të gjitha faturat dhe shpenzimet e Programit dhe tregojnë financimin nga Suedia, në formë dhe me detaje që mundësojnë identifikimin e disburseve në dokumentin e miratuar të Programit, planin e punës, duke përfshirë buxhetin e miratuar, i cili mundëson krahasimin e shpenzimeve me planin aktual dhe buxhetin.

7.2. Pasqyrat financiare gjashtëmujore dhe raportet financiare përfshijnë informacione mbi shumën e marrë, si në valutën e transferimit dhe shumën në monedhën vendëse, kursin e këmbimit valutor dhe informacione mbi datën kur kjo shumë është kredituar. Raporti përfshin, gjithashtu, informacione për shpenzimet totale të kryera, të ndara në përputhje me zërat e miratuar të buxhetit, për periudhën e raportimit, si dhe shumën e mbledhur për të gjithë periudhën e Programit.

7.3 Miratimi i raportit përfundimtar do të bëhet nga Suedia, në konsultim me Komitetin Drejtues të Projektit.

Neni 8

Raporti përshkrues

8.1 Ekipi i menaxhimit të programit /konsulenti i zbatimit do t'i vënë në dispozicion

palës shqiptare, Suedisë dhe Komitetit Drejtues të Projektit, në formë të shkruar, një raport përshkrues çdo gjashtë muaj. Raporti përshkrues duhet të përmbajë një analizë të ecurisë së aktiviteteve të programit dhe rezultatet e pritshme, duke ndjekur strukturën e dokumentit të programit, kuadrin e rezultateve, siç shtjellohen më tej në planet vjetore të punës. Raporti do të mbulojë periudhën kohore prej gjashtë muajsh, nga fillimi i programit dhe do të dorëzohet brenda dy muajve pas kësaj periudhe. Raporti gjashtëmujor përmban një llogaritje, mbi baza kumulative, e cila mbulon të gjithë periudhën e Programit/Projektit, për sa i përket:

- aktiviteteve të realizuara gjatë periudhës së raportimit;
- rezultateve të arritura në krahasim me rezultatet e planifikuara;
- rezultatit/eve të objektivit/objektivave të arritur të krahasuar me objektivin/objektivat e rezultateve të planifikuara (ose progresin drejt arritjes së objektivit/objektivave të rezultateve dhe një vlerësim të mundësisë për arritjen e objektivave të rezultateve të planifikuara;
- një vlerësim të faktorëve të riskut që mund të ndikojnë në arritjen e objektivave; dhe
- një vlerësim të përshatjeve të mundshme në zbatimin e Programit, duke përfshirë menaxhimin e riskut.

8.2 Miratimi përfundimtar i raportit do të kryhet nga Suedia në konsultim me Komitetin Drejtues të Projektit. Raporti mund t'i vihet në dispozicion publikut shqiptar nëpërmjet palës shqiptare.

8.3 Ekipi i menaxhimit të programit /konsulenti zbatues do t'i dorëzojë Shqipërisë dhe Suedisë, me shkrim, një raport për përfundimin e Programit. Raporti përfundimtar duhet të përmbajë një llogari, mbi baza kumulative, e cila mbulon të gjithë periudhën e aktivitetit, për:

- rezultatet e arritura në krahasim me rezultatet e planifikuara;
- objektivin/objektivat e rezultateve të arritura në krahasim me objektivin/objektivat e rezultateve të planifikuara;
- një vlerësim të faktorëve që kanë ndikuar në arritjen e objektivave;
- mësimet e nxjerra nga zbatimi i Programit /Projektit; dhe



- një vlerësim të nevojave të mundshme për rregullime në Program, duke përfshirë veprimet që lehtësojnë riskun.

Pala shqiptare mund t'ua shpërndajë raportin palëve të interesuara dhe publikut shqiptar.

8.4 Pala shqiptare do t'i sigurojë palës suedeze të gjitha informacionet që lidhen me zbatimin e Programit, siç mund të kërkohen nga Suedia.

Neni 9

Këshillimet

9.1 Palët do të bashkëpunojnë dhe do të komunikojnë rregullisht me njëra-tjetrën për të gjitha çështjet që lidhen me zbatimin e Programit dhe të kësaj Marrëveshjeje të Posaçme.

9.2 Palët duhet të takohen të paktën çdo gjashtë muaj, nën kujdesin e Komitetit Drejtues të Projektit, për të diskutuar mbi zbatimin e Programit. Përbërja e Komitetit Drejtues të Projektit përfshin, por nuk kufizohet, tek Ambasada e Suedisë, Ministria e Punëve të Brendshme, Policia e Shtetit, Departamenti për Programet Zhvillimore, Financimin dhe Ndihmën e Huaj në Kryeministri, shoqatat e qeverive lokale, Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Arsimit dhe shoqërinë civile. Komiteti Drejtues i Projektit ka një rol konsultues në miratimin e raporteve. Takimet duhet të mbledhen dhe drejtohen nga pala shqiptare, nëpërmjet Policisë Shqiptare të Shtetit, në koordinim me partnerë të rëndësishëm për zhvillimin e Programit ose sektorit, si nga institucionet qeveritare edhe nga komuniteti i donatorëve.

9.3 Raportet gjashtëmuajore financiare dhe përshkruese të programit u jepen dhe u shpërndahen Shqipërisë dhe Suedisë, si dhe anëtarëve të tjerë të Komitetit Drejtues të Projektit nga konsulenti zbatues, të paktën dhjetë ditë pune para takimit. Kur është e përshtatshme, të dhëna të tjera, si: raporte të rishikimeve dhe vlerësimeve, planet vjetore dhe afatmesme, buxhetet për programin etj., do të shpërndahen në të njëjtën periudhë kohore.

9.4 Tematikat kryesore që do të diskutohen gjatë takimeve të Komisionit Drejtues të Projektit përfshijnë, por nuk kufizohen, te zbatimi i Marrëveshjes së Posaçme, vlerësimi /rishikimi i performancës në lidhje me grupet e synuara, zbatimi i buxhetit dhe nevojat financiare, prioritetet e shpenzimeve në bazë të prodhimit

dhe treguesit e rezultateve të përshkruara në kornizën e rezultateve, rezultati i vizitave në terren, rishikimi i planeve të veprimit/buxhetit për vitin kalendarik të ardhshëm/prioritetet e të ardhurave dhe shpenzimeve; ndjekja e kërkuar për auditime dhe vlerësime.

9.5 Rezultati i takimit regjistrohet në procesverbalet e miratuara. Procesverbalet e miratuara hartohen nga konsulenti zbatues dhe drafti do t'i kalohet palës suedeze dhe palës shqiptare për miratim/komente, brenda një jave pas takimit. Pala suedeze dhe pala shqiptare do të informojnë mbi miratimin/komentet e tyre brenda pesë ditësh pune pas marrjes së draftit.

9.6 Takime të tjera konsultative mund të kërkohen nga pala shqiptare dhe/ose pala suedeze, për çdo subjekt që ka lidhje me zbatimin e Programit.

9.7 Pala shqiptare do të informojë menjëherë Suedinë për çdo rrethanë që mund të pengojë ose të rrezikojë të ndërhyjë në zbatimin e suksesshëm të Programit dhe me synim zgjidhjen e çështjes, do të kërkojë mbajtjen e një takimi për të informuar apo për t'u konsultuar me palën suedeze mbi masat korrigjuese, nëse ka, të cilat duhet të ndërmerren.

Neni 10

Angazhimet e ndërmarrja nga pala shqiptare

10.1 Pala shqiptare merr përsipër të organizojë mbledhjet e Komitetit Drejtues të Programit, duke ftuar ministrinë e tjera përkatëse dhe anëtarët e tjerë që lidhen me qeverinë lokale dhe shoqërinë civile. Duke konsideruar Policinë e Shtetit si përfituesin kryesor të programit, takimet e Komitetit Drejtues të Programit do të kryesohen nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit ose, në rast të mungesës së parashikuar, nga një prej zëvendës drejtorëve të përgjithshëm.

10.2 Pala shqiptare ndërmerr të sigurojë burimet e nevojshme njerëzore dhe mbështetjen institucionale të nevojshme për zbatimin e suksesshëm të programit.

10.3 Pala shqiptare do të sigurojë fonde në kohën e duhur për të mbuluar pagesën e TVSH-së për çdo pajisje të blerë nga programi dhe që do të bëhet pronë e Policisë Shqiptare të Shtetit, në fund të projektit.



10.4 Në lidhje me inaugurimet e punëve infrastrukturore të kryera në kuadër të programit me financimin e palës suedeze, pala shqiptare merr përsipër t'i organizojë ato në bashkëpunim me palën suedeze, në mënyrë që të lejojë pjesëmarrjen e pranisë së Ambasadës Suedeze në çdo rast.

10.5 Pala shqiptare do t'i sigurojë palës suedeze informacionin përkatës dhe të përditësuar mbi zhvillimet në sektor që mund të ndikojnë në zbatimin e programit dhe arritjen e rezultateve të tij të planifikuara, siç janë programe të reja të asistencës ndërkombëtare në të ardhmen apo fonde shtetërore.

Neni 11 Monitorimi

11.1 Pala shqiptare dhe Suedia do të monitorojnë progresin dhe performancën e Programit dhe arritjen e rezultateve të tij të pritshme dhe rezultateve të matura në kornizën e rezultateve. Kjo do të bëhet kryesisht përmes takimeve të Komitetit Drejtues të Programit dhe raportimeve, por mund të përfshijë, gjithashtu, vizita të përbashkëta në terren, informime, vlerësim dhe rishikime. Pala shqiptare dhe Suedia do të mbajnë një dialog të ngushtë në lidhje me mbështetjen dhe zbatimin e Programit.

Neni 12 Vlerësimi

Nëse Suedia kryen një vlerësim (të përkohshëm apo *ex post*) ose një mision monitorues, pala shqiptare duhet të ndërmarrë për të siguruar çdo dokument apo informacion që do të ndihmojë misionin e vlerësimit apo të monitorimit dhe do të mundësojë të drejtat e nevojshme për akses.

Nëse një palë kryen ose autorizon një vlerësim gjatë Programit, ajo duhet t'i japë palës tjetër një kopje të raportit të vlerësimit.

Neni 13 Auditimi

13.1 Auditimi i jashtëm do të kryhet nga një auditues i jashtëm i pavarur dhe i kualifikuar. Auditimi do të kryhet në përputhje me standardet ndërkombëtare të lëshuara nga Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të

Auditimit (INTOSAI) ose të Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve (FNK) ose në përputhje me standardet e krahasueshme kombëtare. Konsulenti i zbatimit do të jetë subjekt auditimi dhe do të jetë përgjegjës për prokurimin e audituesit të jashtëm. Suedia miraton përzgjedhjen e audituesit. Kostoja e tij do të mbulohet nga buxheti i programit i alokuar nga Suedia.

Termet standardë të referencës të SIDA-s për auditimin financiar do të përdoren si referencë dhe termet përfundimtarë të referencës do të miratohen nga Suedia.

Nëse auditimi përmban ndonjë rekomandim, Suedia do të duhet t'ia japë këto të fundit Shqipërisë, brenda tri javëve nga marrja e një përgjigjeje mbi menaxhimin, duke përfshirë një plan veprimi. Plani i veprimit do të raportohet me shkrim nga konsulenti zbatues çdo 6 muaj.

13.2 Suedia mund të autorizojë ose të kërkojë në çdo kohë ndonjë auditim shtesë (të tilla si auditime prokurimi apo ligjore), ndjekje apo studime financiare. Pala shqiptare do të bashkëpunojë me të dhe do të ndihmojë Suedinë për auditime të tilla.

Shpenzimet për auditimet shtesë, përveç auditimeve të rregullta vjetore, do të financohen nga Suedia.

Neni 14 Shlyerja

Suedia do të përcaktojë shumën përfundimtare të kontributit pas marrjes dhe miratimit të raportit/raportëve përfundimtare (narrative /financiare) dhe llogarive të audituara të Programit dhe të të gjitha faturave nga konsulenti zbatues. Fondet që janë vendosur tek EMP/konsulenti zbatues dhe të cilat mbeten pas përfundimit të Programit, do të kthehen në Suedi brenda 60 ditëve pas miratimit të auditimit financiar.

Suedia do të informojë Shqipërinë për shumën që do të duhet të shlyhet në Suedi, si dhe mbi valutën e preferuar dhe të dhënat bankare.

Neni 15 Korrupsioni

15.1 Palët do të bashkëpunojnë për parandalimin e mashtrimit dhe të korrupsionit në lidhje me Programin dhe do të kërkojnë që



personeli i përfshirë, si dhe konsulentët /furnizuesit/kontraktuesit e financuar sipas Programit të evitohen për t'iu ofruar palëve të treta apo për t'iu kërkuar, pranuar apo për t'u premtuar nga palë të treta, për veten e tyre apo ndonjë palë tjetër, ndonjë dhuratë, shpërblim, kompensim apo përfitim të çdo lloji, e cila mund të interpretohet si një praktikë e paligjshme apo korruptive.

15.2 Palët do të informojnë menjëherë njëra-tjetrën për rastet apo dyshimet e mashtrimit apo korrupsionit, siç referohet në këtë nen dhe për masat e marra, siç referohet në nënparagrafin vijues.

15.3 Palët do të veprojnë shpejt për të ndaluar, për të filluar hetime dhe nëse është e rëndësishme, për të ndërmarë veprime, me qëllim fillimin e ndjekjes penale dhe/ose për të zbatuar sanksionet në përputhje me ligjet dhe politikat e zbatueshme ndaj çdo personi të dyshuar për keqpërdorim të burimeve, mashtrim apo korrupsion në lidhje me Projektin /Programin.

Neni 16

Rregullimet ligjore

16.1 Në rast të mosrespektimit nga ana e palës shqiptare të dispozitave të kësaj Marrëveshjeje të Posaçme, Suedia rezervon të drejtën të ushtrojë zgjidhjet e mëposhtme, duke përfshirë bllokimin e pagesave të mëtejshme dhe/ose uljen e pagesave të reja, duke kërkuar kthimin e fondeve të disbursuara ose ndërprerjen e mbështetjes së saj për Projektin/Programin.

16.2 Në rast të shkeljes së Marrëveshjes, Suedia mund të ndërpresë Marrëveshjen nëpërmjet një njoftimi dy muaj para.

16.3 Në rast të një shkeljeje të rëndë të Marrëveshjes, Suedia mund të ndërpresë Marrëveshjen me efekt të menjëhershëm.

16.4 Në rast të ndërprerjes nga Suedia, ndërprerja nuk do të zbatohet për fondet e zotuar në mirëbesim nga ana e Shqipërisë për palët e treta, para datës së njoftimit të ndërprerjes, me kusht që angazhimet të jenë bërë në përputhje me këtë Marrëveshje.

16.5 Ndërprerja do të kryhet pas një njoftimi me shkrim në lidhje me të.

Neni 17

Njohja dhe informacioni

Duke iu referuar veprimtarive plotësisht ose pjesërisht të financuara në përputhje me këtë Marrëveshje, pala shqiptare kurdoherë do të njohë dhe do të bëjë publike aktivitetet e financuara përmes ndihmës suedeze për zhvillim. Logoja e Suedisë do të përdoret në përgatitjen e materialeve informative dhe në lidhje me aktivitetet informuese. Prodhimi i materialeve të tilla është plotësisht përgjegjësi e palës shqiptare/Programit dhe përgjegjësia e përmbytjes do të jetë e botuesit. Termat “SIDA” ose “Suedia” nuk mund të përdoren në mënyrë të tillë që mund të perceptohet sikur SIDA apo Suedia ka marrë pjesë në përgatitjen apo mbështetjen e ndonjë prej opinioneve të paraqitura. SIDA dhe departamentet e tjera të administratës suedeze jashtë vendit rezervojnë të drejtën për të kopjuar dhe për të shpërndarë materiale të kësaj natyre, nëse kërkohet.

Neni 18

Përfundimi

Kjo Marrëveshje do të mbetet e vlefshme deri më 31 dhjetor 2021, përveç kur palët e ndërpresin para kohe duke i dërguar njëra-tjetrës një njoftim me shkrim gjashtë muaj para. Në rast të ndërprerjes para kohe nga pala shqiptare, asnjë fond nuk do të jetë më në dispozicion për aktivitete pas gjashtë muajve nga njoftimi me shkrim. Të gjitha të drejtat dhe detyrimet e palëve sipas kësaj Marrëveshjeje do të vazhdojnë të mbeten të pacenuara deri në kthimin e fondeve të mbetura/balancës së fondeve të Suedia dhe plotësimin e kërkesave të raportimit të kësaj Marrëveshjeje, në kohën kur kësaj Marrëveshjeje i kalon afati.

Neni 19

Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi kur Suedia të ketë marrë njoftim me shkrim nga pala shqiptare, ku do të konfirmohet përfundimi i procedurave të brendshme shqiptare të nevojshme për hyrjen në fuqi të Marrëveshjes. Kjo marrëveshje do të zbatohet përkohësisht nga nënshkrimi i saj në masën që dispozitat e kësaj Marrëveshjeje të mos bien në kundërshtim me legjislacionin e Shqipërisë apo të Suedisë.



Kjo Marrëveshje specifike është nënshkruar në gjuhën angleze në dy kopje origjinale, një për secilin nënshkrues.

Vendi dhe data

Për Suedinë,
përfaqësuar nga
Agjencia Suedeze e
Bashkëpunimit
Ndërkombëtar për
Zhvillim (SIDA)
Nënshkrimi
Saimir Tahiri
Ministër i Punëve të
Brendshme

Vendi dhe data

Për palën shqiptare
Nënshkrimi
Birgitta Jansson
Këshilltare, Shefe e
Seksionit të
Bashkëpunimit për
Zhvillim në Ambasadën
e Suedisë

VENDIM
Nr. 98/2017

**PËR NGRITJEN E NËNKOMISIONIT
“PËR DIASPORËN DHE
MIGRACIONIN”, NË PËRBËRJE TË
KOMISIONIT TË PËRHERSHËM
PARLAMENTAR PËR POLITIKËN E
JASHTME**

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës dhe të neneve 19, pika 2, dhe 21, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Konferencës së Kryetarëve,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Ngrihet nënkomisioni “Për diasporën dhe migracionin”, në përbërje të Komisionit të Përhershëm Parlamentar për Politikën e Jashtme.

II. Objekti dhe fusha e përgjegjësive së këtij nënkomisioni janë çështje të diasporës dhe fenomenit migrator të Shqipërisë.

III. Nënkomisioni përbëhet nga 5 anëtarë si më poshtë:

- | | | |
|-----------------------|-----------------|-------|
| 1. Adnor Shameti | Kryetar | (PS) |
| 2. Tritan Shehu | Zëvendëskryetar | (PD) |
| 3. Elona Hoxha | Anëtare | (PS) |
| 4. Eglantina Gjermani | Anëtare | (PS) |
| 5. Klajda Gjasha | Anëtare | (LSI) |

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Gramoz Ruçi

Miraturar në datën 5.10.2017

VENDIM
Nr. 99/2017

**PËR NGRITJEN E NËNKOMISIONIT
“PËR QEVERISJEN VENDORE”,
NË PËRBËRJE TË KOMISIONIT TË
PËRHERSHËM PARLAMENTAR
PËR ÇËSHTJET LIGJORE,
ADMINISTRATËN PUBLIKE
DHE TË DREJTAT E NJERIUT**

Në mbështetje të nenit 78/1 të Kushtetutës dhe të neneve 55/1, 19/2 e 21/1 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Konferencës së Kryetarëve,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Ngrihet nënkomisioni “Për qeverisjen vendore”, në përbërje të Komisionit të Përhershëm Parlamentar për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

II. Fusha e përgjegjësive së këtij nënkomisioni është organizimi dhe funksionimi i pushtetit vendor.

III. Nënkomisioni përbëhet nga 7 anëtarë si më poshtë:

- | | | |
|--------------------|-----------------|-------|
| 1. Bashkim Fino | Kryetar | (PS) |
| 2. Oerd Bylykbashi | Zëvendëskryetar | (PD) |
| 3. Edmond Leka | Anëtar | (PS) |
| 4. Saimir Tahiri | Anëtar | (PS) |
| 5. Klotilda Bushka | Anëtare | (PS) |
| 6. Nasip Naço | Anëtar | (LSI) |
| 7. Dhurata Çupi | Anëtare | (PD) |

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Gramoz Ruçi

Miraturar në datën 5.10.2017

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2017

Adresa: Rr "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel/fax +355 4 24 27 004 Tel +355 4 24 27 006

Çmimi 112 lekë